

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **644-26-3046-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Best D.D.D. SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr.Vellezerit Gervalla**

(Adresa)

**Ferizaj**

**70000**

(Vendi)

(Kodi postar)

**049851805**

**N/A**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Florian Syla**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


**Floriansyla23@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**15.09.2026**

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe yllja)


*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

**B05 Njoftim per Kontrat 06.05.2026 00:00**

**Procesverbali i hapjes -3046.pdf 03.06.2026 10:21**

**B47 KERKESE PER SQARIM TE DT.pdf 05.06.2026 11:36**

**LETËR SQARUESE PËR TENDERIN ME NR. TË PROKURIMIT 644-26-3046-2-2-1.pdf 07.06.2026 17:11**

**B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK DDD dhe largimi i zvarranikëve brejtësve.pdf 08.06.2026 12:29**

**KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE.pdf 08.06.2026 12:59**

**Vendimi i AK Lejimi i Qasjes 08.06.2026.pdf 08.06.2026 13:22**

**Kërkesë për rishqyrtim - Best D.D.D. SH.P.K. 11.06.2026 18:55**

**Konkluzion mbi pezullimin e perkoheshem.pdf 12.06.2026 08:29**

**VENDIMI REFUZUES I AK 12.06.2026\_compressed.pdf 12.06.2026 16:17**

**Ankesë 400-26.pdf 19.06.2026**

**Raporti\_Ekspertit\_2026 0400.pdf 06/07/2026**

**Mospajtim me mendimin e ekspertit shqyrtues - - Raporti\_Ekspertit\_2026 0400 - BEST D.D.D. SH.P.K.pdf 08.07.2026 16:06**

**Kundershtim ne mospajtimin e AK per raportin e Ekspertit - 2026 0400.pdf 10.07.2026 13:52**

**Deshmi per pretendimin 5.2.pdf 10.07.2026 13:59**

**Deshmi mbi Mospajtimin me mendimin e ekspertit shqyrtues lidhur me Pretendimin nr 4.3.pdf 10.07.2026 14:04**

**Vendimi\_2026 0400.pdf 22/07/2026**

**Kërkesë urgjente për zgjatjen e validitetit të ofertës - Best D.D.D. SH.P.K..pdf 31.07.2026 13:48**

**Konfirmim për zgjatjen e validitetit të ofertës - Best D.D.D. SH.P.K..pdf 31.07.2026 15:00**

**B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK DDD dhe largimi i zvarranikëve brejtësve 31.08.2026.pdf 31.08.2026 08:37**

**KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE 31.08.2026.pdf 31.08.2026 11:14**

**Vendim-Njoftim i AK lidhur me qasjen ne dokumente 31.08.2026.pdf 31.08.2026 12:29**

**Qartësim dhe plotësim i kërkesës për qasje në dokumentet e rivlerësimit.pdf 31.08.2026 15:11**

**Sigurimi i Tenderit II 01.09.2026 - Best D.D.D. SH.P.K..pdf 31.08.2026 15:15**

**Përgjigje ndaj kërkesës për qasje në dokumentet e rivlerësimit.pdf 01.09.2026 08:14**

**Kërkesë për rishqyrtim - Kërkesë për rishqyrtim 04.09.2026 - Best D.D.D. SH.P.K. 04.09.2026 13:49**

**DDD VENDIMI REFUZUES I AK 07.09.2026.pdf 07.09.2026 09:41**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☒

Jo ☐

**Hapja e ofertave eshte bere permes platformes se E-prokurimit**

##### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

##### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

Kundër **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2026**, me të cilin GOE: Best D.D.D. SH.P.K.; Shaqir Brahimi B.I.; VLERA SH.P.K., janë eliminuar dhe është rekomanduar për kontratë OE **S.V. "Veterina" / Safet Osmani B.I.**, kemi parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, me datë **04.09.2026**. Autoriteti Kontraktues, me Vendimin e datës **07.09.2026**, ka refuzuar kërkesën tonë si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi B58 të datës 31.08.2026.

Në bazë të **nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar**, dhe pas shterimit të procedurës paraprake sipas nenit 108/A, paraqesim këtë **Ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit**, kundër rezultatit të rivlerësimit, B58 të datës 31.08.2026, Vendimit të datës 07.09.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, si dhe Letrës standarde për GOE-në e eliminuar/të pasuksesshëm.

Kërkojmë **anulimin e akteve të kundërshtuara dhe korrigjimin e vlerësimit të ofertave**, pasi konsiderojmë se Vendimi i datës 07.09.2026 nuk i rrëzon në mënyrë të argumentuar faktet dhe provat e paraqitura nga GOE-ja jonë. Për disa nga çështjet vendimtare, AK-ja kufizohet në përfundime të përgjithshme, pa identifikuar në mënyrë të mjaftueshme dokumentin, faktin dhe analizën konkrete që do të justifikonte refuzimin e pretendimeve tona.

GOE-ja jonë është pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në këtë aktivitet dhe preket konkretisht nga elimnimi dhe rekomandimi i OE-së S.V. "Veterina". Oferta jonë është evidentuar me vlerë **47,772.00 €**, ndërsa oferta e OE-së së rekomanduar me **51,464.00 €**, respektivisht me diferencë prej **3,692.00 €**. Për këtë arsye kemi interes të drejtpërdrejtë juridik dhe ekonomik që fillimisht të bëhet vlerësimi i ligjshëm i përgjegjshmërisë së tenderëve dhe më pas të zbatohet kriteri për dhënien e kontratës.

Kjo procedurë duhet parë edhe në vazhdimësi me **Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400, datë 22.07.2026**, me të cilin ankesa jonë e mëparshme është aprovuar, B58 i atëhershëm është anuluar dhe aktiviteti është kthyer në rivlerësim. Pas këtij vendimi, AK ka nxjerrë aktin përkatës të anulimit më **23.07.2026**, ndërsa më **31.08.2026** ka rekomanduar përsëri të njëjtin OE për kontratë.

Më **04.09.2026**, në Kërkesën për Rishqyrtim kemi ngritur **gjashtë pretendime**, ndërsa me Vendimin e datës **07.09.2026**, AK-ja i ka refuzuar të gjitha si të pabazuara.

Në vijim, **ruajmë të njëjtat gjashtë pretendime**, duke paraqitur për secilin: pretendimin e ngritur në Kërkesën për Rishqyrtim, qëndrimin/përgjigjen e Autoritetit Kontraktues në Vendimin e datës 07.09.2026, si dhe **kundërshtimin dhe kundërargumentet tona ndaj këtij arsytimi**.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- **Neni 6 i LPP-së** – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- **Neni 7 i LPP-së** – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi
- **Neni 28 i LPP-së** – Specifikimet teknike.
- **Neni 51 i LPP-së** – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes.
- **Neni 56 i LPP-së, paragrafi 3** – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave.
- **Neni 57 i LPP-së** – Sigurimi i Tenderit.
- **Neni 59 i LPP-së, paragrafi 4** – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve.
- **Neni 60 i LPP-së** – Kriteret për Dhënien e Kontratës.
- **Neni 64 i LPP-së** – Dëshmitë e kërkesave.
- **Neni 65 i LPP-së, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3** – konflikti i interesit. – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve.
- **Neni 69 i LPP-së** – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.
- **Neni 72 i LPP-së** – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.
- **Neni 108/A, paragrafi 12 i LPP-së** – detyrimi që vendimet e marra sipas paragrafit 10 të jenë të arsyetuara dhe të komunikohen me shkrim.
- **Neni 131 i LPP-së** – Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues.
- **Neni 19 i Rregullores Nr. 001/2022** – Specifikimet Teknike.
- **Neni 30, paragrafi 30.4 i Rregullores Nr. 001/2022** – Validiteti i Tenderit / kërkesa për zgjatjen e validitetit
- **Neni 30, paragrafi 30.5** – kërkesa për zgjatjen edhe të validitetit të sigurimit të tenderit

- **Neni 40, paragrafi 40.1 i Rregullores** – përgjegjësia e Komisionit Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve
- **Neni 40, paragrafi 40.2** – vlerësimi sipas kriterëve të NJK/DT dhe ndalimi i ndryshimit, modifikimit, heqjes ose shtimit të kërkesave, kriterëve apo specifikimeve gjatë vlerësimit
- **Neni 40, paragrafi 40.2.1** – rivlerësimi për korrigjimin e parregullsive të mundshme ligjore sipas Vendimit të OSHP-së.
- **Neni 40, paragrafi 40.6, pika c)** – tenderi konsiderohet i përgjegjshëm kur është dorëzuar nga OE që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në DT.
- **Neni 40, paragrafi 40.12** – ndalimi i diskualifikimit ose përjashtimit mbi bazën e kërkesës apo kriterit që nuk është specifikuar në NJK/DT.
- **Neni 97, paragrafi 97.1, pikat d), e), f) dhe h) të Rregullores** – Shkeljet e rënda mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së/KRPP-së.
- **Pika 10.1 e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, i plotësuar/ndryshuar me Udhëzuesin Nr. 002/2024** – lista e kontratave të realizuara që nuk përmbush vlerën minimale: “Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Kjo Ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) paraqitet pas përfundimit të procedurës paraprake të rishqyrtimit pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve**”, me Nr. të Prokurimit **644-26-3046-2-2-1**.

Pas publikimit të **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 31.08.2026**, të nxjerrë pas procesit të rivlerësimit të urdhëruar me Vendimin e OSHP-së nr. **2026/0400, datë 22.07.2026**, GOE-ja jonë ka parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim më 04.09.2026**. Me Vendimin e datës **07.09.2026**, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi rezultatin e rivlerësimit.

Ne konsiderojmë se **Vendimi i AK-së i datës 07.09.2026 nuk i adreson dhe nuk i rrëzon në mënyrë të plotë, konkrete dhe të argumentuar faktet, provat dhe bazën juridike të paraqitur në Kërkesën tonë për Rishqyrtim**. Për çështje vendimtare të procedurës, AK-ja ka dhënë përfundime të përgjithshme, ndërsa problemet e ngritura gjatë rivlerësimit dhe konstatimet e procedurës së mëparshme pranë OSHP-së vazhdojnë të mbeten të kontestuara.

Ankesa jonë mbështetet në **Dosjen e Tenderit, Njoftimin për Kontratë, ofertat dhe dokumentacionin e operatorëve ekonomikë, Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400, Raportin e Ekspertit Shqyrtues,**

Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 31.08.2026, Kërkesën për Rishqyrtim të datës 04.09.2026, Vendimin refuzues të AK-së të datës 07.09.2026, komunikimet zyrtare me AK-në, dokumentacionin e siguruar përmes qasjes në dokumente, si dhe provat dhe verifikimet shtesë të siguruara nga GOE-ja jonë.

Në vijim paraqesim në mënyrë të veçantë secilin pretendim ankimor, duke trajtuar **mënyrën e vlerësimit të certifikatave DDD, moszbatimin përmbajtësor të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400, validitetin dhe sigurimin e tenderit, mosplotësimin e kriterit minimal të kontratave të natyrës së ngjashme nga OE i rekomanduar, përsëritjen e të njëjtit rezultat gjatë rivlerësimit, si dhe rrethanat që ngrenë dyshime të arsyeshme për konflikt interesi dhe kërkojnë verifikim të mëtejshëm nga OSHP-ja.**

### ***Pretendimi Nr.1***

#### ***Mosrespektimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400 dhe eliminimi i pabazuar mbi interpretimin formal të certifikatave DDD***

Ne kundërshtojmë arsyen e eliminimit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, në Njoftimin mbi Vendimin e datës **31.08.2026**.

Aktiviteti është kthyer në rivlerësim me Vendimin e OSHP-së nr. **2026/0400, datë 22.07.2026**, me të cilin ankesa jonë është aprovuar si plotësisht e bazuar, vendimi paraprak i AK-së është anuluar dhe aktiviteti është kthyer në rivlerësim. Paneli Shqyrtues, pikërisht lidhur me stafin teknik të trajnuar për DDD, kishte vlerësuar se qasja e Ekspertit Shqyrtues kishte qenë tepër e ngushtë.

Megjithatë, gjatë rivlerësimit AK përsëri e ka bazuar eliminimin tonë në interpretimin e formulimit **“mori pjesë në trajnim”**, si dhe në faktin se trajnimi është zhvilluar **ONLINE**.

Certifikatat e z. **F.Syla – AQS/T/S127962024** dhe z. **B.Ismaili – AQS/T/S127972024** janë lëshuar për **“Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD”**, për programin e zhvilluar nga **31.07.2024 deri më 03.08.2024**, me kohëzgjatje **32 orë**, dhe përmbajnë komponentë teorikë dhe praktikë.

Dosja e Tenderit ka kërkuar:

**“Kopje të Certifikatave për kryerjen e trajnimit për shërbimin DDD”.**

Dosja nuk ka kërkuar formulimin **“ka kryer me sukses”**, nuk ka ndaluar trajnimin ONLINE dhe nuk ka përcaktuar që pjesa praktike duhet të zhvillohet domosdoshmërisht fizikisht. Për këtë arsye, këto elemente nuk mund të shndërrohen pas dorëzimit të ofertave në kritere të reja për eliminim.

#### **Sqarimi i drejtpërdrejtë nga institucioni lëshues**

Për eliminimin e çdo paqartësie, më **01.09.2026** i jemi drejtuar drejtpërdrejt **AQS CERT**, institucionit që ka zhvilluar trajnimin dhe ka lëshuar certifikatat, duke kërkuar konfirmim për autenticitetin, vlefshmërinë, përfundimin e trajnimit, kuptimin e formulimit **“mori pjesë”**, komponentin praktik dhe ndikimin eventual të formatit ONLINE.

## PROVA NR.1 – Kërkesa për verifikim dhe sqarim drejtuar AQS CERT

### Kërkesë për verifikim dhe sqarim zyrtar të Certifikatave të Trajnimit DDD

1 message

Florian Sylja <floriansylja23@gmail.com>  
To: AQSCert Info <info@aqscert.org>

Të nderuar përfaqësues të AQS CERT,

Ju drejtohem me kërkesë për verifikim dhe sqarim zyrtar lidhur me dy certifikata të lëshuara nga institucioni juaj:

- Florian Sylja – Certifikata Nr. AQS/T/S127962024
- Besart Ismaili – Certifikata Nr. AQS/T/S127972024

Certifikatat janë lëshuar për kursin "Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD", me trajnim të zhvilluar në periudhën 31.07.2024 – 03.08.2024, me kohëzgjatje 32 orë.

Për shkak se këto certifikata janë duke u përdorur si dëshmi profesionale në një procedurë të prokurimit publik, ju lutemi të na konfirmoni zyrtarisht:

1. Nëse certifikatat e sipërpërmendura janë autentike, valide dhe të lëshuara rregullisht nga AQS CERT.
2. Nëse Florian Sylja dhe Besart Ismaili e kanë ndjekur dhe përfunduar trajnimin/kursin për kryerjen e shërbimeve DDD, sipas programit të përcaktuar në certifikatë.
3. Nëse shprehja "Mori pjesë në trajnimin me temë: Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD" nënkupton përfundimin e programit të trajnimit për të cilin është lëshuar certifikata dhe jo vetëm një pjesëmarrje formale.
4. Nëse programi i trajnimit ka përfshirë modulën teorik dhe modulën praktik të specifikuar në certifikatë.
5. Nëse zhvillimi i trajnimit ONLINE ndikon në ndonjë mënyrë në vlefshmërinë ose statusin profesional të certifikatës së lëshuar.
6. Nëse këto certifikata dëshmojnë se personat e certifikuar kanë përfunduar trajnimin për kryerjen e shërbimeve të Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD).

Do t'ju ishim mirënjohës nëse përgjigjen mund të na e dërgoni në formë të shkruar dhe zyrtare, pasi e njëjta do të përdoret si dëshmi për sqarimin e vlefshmërisë së certifikatave pranë institucioneve publike në Republikën e Kosovës.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë kopjet e të dy certifikatave për verifikim.

Me respekt,  
Florian Sylja  
BEST D.D.D. SH.P.K.

2 attachments

 Certifikat Trajnimi DDD - Florian Sylja.pdf  
882K

 Certifikat Trajnimi DDD - Besart Ismaili.pdf  
892K

Në përgjigje, AQS CERT ka lëshuar **Shkresën zyrtare Nr. 54 Prot., datë 02.09.2026**, posaçërisht për certifikatat e F.Sylja dhe B.Ismaili.

**Nr. 54 Prot**

**Date:02/09/2026**

**Best D.D.D. SH.P.K**

Vellezerit Gervalla , pn, Ferizaj, Kosovë

**Lënda: Sqarim zyrtar mbi vlefshmërinë e certifikatave të trajnimit për shërbimet DDD**

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për verifikim dhe sqarim lidhur me certifikatat e trajnimit të z. Florian Sylja, me Certifikatë Nr. AQS/T/S127962024, dhe z. Besart Ismaili, me Certifikatë Nr. AQS/T/S127972024, për kursin "Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD", AQSCERT, në cilësinë e organizmit që ka zhvilluar trajnimin dhe ka lëshuar certifikatat përkatëse, ju konfirmon si vijon:

#### 1. Mbi autenticitetin dhe vlefshmërinë e certifikatave

Të dyja certifikatat e sipërcituara janë autentike, të vlefshme dhe të lëshuara në mënyrë të rregullt nga AQSCERT, në përputhje me procedurat dhe dokumentacionin përkatës të organizmit. Certifikatat janë lëshuar pas përfundimit të trajnimit dhe përfaqësojnë dokumentet zyrtare të AQSCERT për personat e trajnuar. Vlefshmëria e certifikatave mund të verifikohet online nëpërmjet faqes zyrtare [www.aqscert.org](http://www.aqscert.org), duke ndjekur udhëzimet e përcaktuara në fund të certifikatës.

#### 2. Mbi ndjekjen dhe përfundimin e trajnimit

Konfirmojmë se z. Florian Sylja dhe z. Besart Ismaili kanë ndjekur dhe kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit "Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD", zhvilluar në periudhën 31.07.2024 – 03.08.2024, me kohëzgjatje totale prej 32 orësh. Certifikatat janë lëshuar mbi bazën e përfundimit të programit të trajnimit dhe jo thjesht mbi bazën e regjistrimit apo pjesëmarrjes formale.

#### 3. Mbi përmbajtjen e programit të trajnimit

Programi i trajnimit ka përfshirë komponentë teorikë dhe praktikë, në përputhje me temat dhe objektivat e përcaktuara për trajnimin në fushën e Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD). Pjesa praktike është realizuar përmes demonstrimeve dhe shembujve praktikë të paraqitur gjatë zhvillimit të trajnimit, me qëllim konkretizimin e njohurive dhe procedurave të nevojshme për kryerjen e shërbimeve DDD.

Për rrjedhojë, pretendimi se trajnimi ka konsistuar vetëm në një pjesëmarrje formale në një kurs online nuk përputhet me mënyrën dhe përmbajtjen reale të trajnimit të zhvilluar nga AQSCERT.

#### 4. Mbi njohuritë dhe kompetencat e përfituara

AQSCERT vlerëson se përfundimi i një programi trajnimi nuk mund të konsiderohet i pavlefshëm vetëm për shkak të mënyrës së transmetimit të tij, për sa kohë që programi është zhvilluar dhe përmbushur nga pjesëmarrësit. Format online është një mënyrë e konsoliduar e zhvillimit të trajnimeve profesionale dhe, kur programi përfshin mekanizma të përshtatshëm për demonstrimin dhe konkretizimin e pjesës praktike, nuk përbën në vetvete pengesë për përfitim të njohurive dhe kompetencave të përcaktuara në program.

#### 5. Mbi përdorimin e certifikatave dhe kompetencat e përfituara

Theksojmë gjithashtu se certifikatat në fjalë janë lëshuar që në vitin 2024 dhe janë përdorur rregullisht që prej asaj kohe, pa u ngritur më parë ndonjë pretendim lidhur me autenticitetin, vlefshmërinë apo mënyrën e zhvillimit të trajnimit. Gjatë kësaj periudhe, personat në fjalë kanë ushtruar aktivitetet përkatëse mbi bazën e njohurive dhe kompetencave të përfituara gjatë trajnimit. Fakti që kjo problematikë ngrihet rreth dy vite pas lëshimit të certifikatave, ndërkohë që ato kanë qenë në përdorim të rregullt dhe personat kanë vijuar të ushtrojnë kompetencat e përfituara, përbën një rrethanë që duhet të merret në konsideratë në vlerësimin e tyre. Në bazë të sa më sipër, AQSCERT konfirmon se certifikatat e lëshuara për z. Florian Syla dhe z. Besart Ismaili dëshmojnë përfundimin e trajnimit përkatës për kryerjen e shërbimeve të Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit (DDD), sipas programit të zhvilluar nga AQSCERT.

Kjo shkresë lëshohet me kërkesë të subjektit përkatës, për t'u përdorur pranë institucioneve kompetente si konfirmim zyrtar nga organizmi lëshues i certifikatave.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,*

*Ju urojmë punë të mbarë!*



Përgjigjja e institucionit lëshues sqaron në mënyrë të drejtpërdrejtë pikërisht çështjet mbi të cilat AK ka bazuar eliminimin tonë:

- certifikatat janë **autentike, të vlefshme dhe të lëshuara rregullisht** nga AQS CERT;
- Florian Syla dhe Besart Ismaili **e kanë ndjekur dhe përfunduar me sukses** programin e trajnimit DDD prej 32 orësh;
- certifikatat janë lëshuar mbi bazën e **përfundimit të programit dhe jo vetëm mbi bazën e pjesëmarrjes formale**;
- programi ka përfshirë **komponentë teorikë dhe praktikë**, ndërsa pjesa praktike është realizuar përmes demonstrimeve dhe shembujve praktikë;
- AQS CERT sqaron se formati ONLINE **nuk e bën të pavlefshëm trajnimin** vetëm për shkak të mënyrës së zhvillimit të tij;
- dhe, përfundimisht, institucioni lëshues konfirmon se këto certifikata dëshmojnë **përfundimin e trajnimit për kryerjen e shërbimeve DDD**.

Ky sqarim është vendimtar. AK e ka interpretuar shprehjen “**mori pjesë në trajnim**” sikur të nënkuptonte vetëm pjesëmarrje formale, ndërsa **vetë institucioni që ka hartuar dhe lëshuar certifikatën konfirmon të kundërtën**: programi është përfunduar me sukses dhe certifikatat janë lëshuar pikërisht mbi bazën e përfundimit të tij.

Po ashtu, përfundimi i AK-së se mënyra ONLINE e zhvillimit të trajnimit e cenon aftësimin profesional nuk mbështetet as në DT/NJK dhe tashmë kundërshtohet drejtpërdrejt edhe nga institucioni që ka zhvilluar trajnimin.

Kjo bëhet edhe më problematike kur krahasohet me trajtimin e dokumentacionit të OE-së së rekomanduar. Për OE-në tonë është përdorur një interpretim jashtëzakonisht formal i dy fjalëve **“mori pjesë”**, ndërsa ndaj dokumentacionit të OE-së së rekomanduar është aplikuar një qasje dukshëm më liberale, përfshirë certifikata për të cilat gjatë procedurës para OSHP-së ishte ngritur çështja e vlefshmërisë së tyre.

Në këto rrethana, pas sqarimit zyrtar të AQS CERT, **arsyeja mbi të cilën është ndërtuar eliminimi ynë nuk qëndron më as faktikisht dhe as në raport me kërkesën konkrete të Dosjes së Tenderit.**

**Për këto arsye, kërkojmë që Pretendimi nr. 1 të aprovohet si i bazuar, të konstatohet se AK ka bërë vlerësim të gabuar të certifikatave DDD të z. F.Syla dhe z. B.Ismaili, të anulohet arsyeja e eliminimit dhe oferta e GOE-së sonë të trajtohet në përputhje me kërkesat reale të DT/NJK, sqarimin zyrtar të institucionit lëshues dhe Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400.**

### **Pergjigja e Autoritetit Kontraktues per pretendimin Nr.1:**

Certifikatat e stafit teknik për shërbimet DDD Parashtruesi pretendon se eliminimi i ofertës së tij është bërë mbi një interpretim formal të formulimit të certifikatave, konkretisht shprehjes "mori pjesë në trajnim", si dhe mbi faktin se trajnimi është zhvilluar online.

Parashtruesi i referohet gjithashtu shkresës së AQS CERT, Nr. 54 Prot., datë 02.09.2026, me të cilën kërkon të dëshmojë se personat përkatës kanë ndjekur dhe përfunduar programin e trajnimit DDD.

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në ofertë dhe dokumenteve të administruara gjatë procedurës, vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga parashtruesi duhet të vlerësohet në raport me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit/Njoftimin për Kontratë.

Fakti që një dokument ose certifikatë është lëshuar nga një subjekt i caktuar nuk e përjashton Autoritetin Kontraktues nga detyrimi për të verifikuar nëse përmbajtja e saj dëshmon përmbushjen e kërkesës konkrete të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Shkresa e AQS CERT, e datës 02.09.2026, është shqyrtuar nga Autoriteti Kontraktues, mirëpo ajo nuk ndryshon përmbajtjen e dokumentacionit të dorëzuar në ofertë dhe nuk mund të përdoret për të krijuar një kriter të ri ose për të ndryshuar kërkesën e përcaktuar në DT/NJK pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimi nuk është i bazuar dhe nuk paraqet bazë për ndryshimin e vendimit të kontestuar.

### **Kundërshtimi ynë:**

Kundërshtojmë këtë arsyetim sepse nuk i përgjigjet përmbajtjes së pretendimit tonë. Ne nuk kemi kërkuar ndryshimin e kriterit dhe as krijimin e një kualifikimi pas afatit të ofertimit. Kemi kërkuar që kriteri i publikuar të zbatohet mbi **kualifikimin e fituar në vitin 2024 dhe të dëshmuar përmes certifikatave të dorëzuara me ofertë.**

Në ofertën fillestare janë paraqitur certifikatat e lëshuara nga AQS CERT për **Florian Sylën, nr. AQS/T/S127962024**, dhe **Besart Ismailin, nr. AQS/T/S127972024**. Këto janë dokumentet mbi të cilat kërkojmë të bëhet vlerësimi dhe për të cilat institucioni lëshues ka dhënë sqarimin përkatës.

**PROVA – Certifikata e Florian Sylës e dorëzuar me ofertë (4. Lista e Stafit.rar - Florian Sylë - Kontrata e punës dhe Certifikata e Trajnimit - Best D.D.D. SH.P.K..pdf)**



## CERTIFIKATË TRAJNIMI

Nr. i Certifikatës **AQS/T/S127962024**

Emri Mbiemri **Z. FLORIAN SYLA**

Datelindja **28-03-2003**

Mori pjese ne trajnimit me teme:

### "Kurs Trajnimi per kryerjen e Sherbimeve DDD".

Temat e trajtuara:

#### MODULI TEORIK:

- 1 - Aspektet rregullatore:
  - EN 16636:2015 "Shërbimet për menaxhimin e dëmtuesve – Kërkesat dhe kompetencat";
  - Dëmtuesit urbanë: Biologjia e dëmtuesve kryesorë;
  - Shënime mbi Entomologjinë.
- 2- Nocionet për biologjinë e insekteve:
  - Buburrecat: njohja, biologjia dhe sjellja në zinxhirin e furnizimit me ushqim
  - Mizat: biologjia dhe kontrolli
  - Mushkonjat: biologjia, sjellja, monitorimi dhe kontrolli
  - Insektet e shtratit: biologjia dhe kontrolli
  - Ektoparazitë të tjerë: mizat e pëllumbave dhe pleshtat – biologjia dhe kontrolli

#### MODULI PRAKTIK:

- 1 - Nocionet për biologjinë e brejtësve:
  - Brejtësit sinantropikë: njohja, biologjia dhe sjellja;
  - Brejtësit në zinxhirin e furnizimit ushqimor: monitorimi, korrigjimi i minjve dhe planet e kontrollit;
  - Përdorimi i produkteve të kontrollit të brejtësve;
  - Kontrolli ekologjik i brejtësve.
- 2 - Kontrolli i aktivitetëve:
  - Metodatat e kontrollit: inspektimi dhe monitorimi (Pest Control);
  - Teknikat e ndërhyrjes (insektet dhe brejtësit);
  - Procedurat e ndihmës së parë.
- 3- Rregullat dhe procedurat për përdorimin e biocidëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve:
  - Vlerësimi i rrezikut;
  - Pajisjet mbrojtëse personale (veshja dhe zhveshja);
  - Mjetet dhe pajisjet;
  - Planifikimi i veprimtarisë;
  - Emergjencat dhe menaxhimi i mbetjeve.



For Certification Body

*Eriola Cami*



XOC FO-AQS-438

Datat e trajnimit 31/07/2024 03/08/2024 Ore 32

Vendi i trajnimit Tirane, Shqiperi - Trajnim i zhvilluar ON-LINE

Organizatorët e trajnimit AQSCERT "Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit"

Datat e leshimit 03/08/2024 Data e skadences 02/08/2027

The validity of the certificate can be checked at <http://aqscert.org/en/#online-aqs-form> following the instructions that are reflected there.

Lector  

AQSCERT Sh.p.k. / Rruga Jusuf Vriani, Pallati 1, Nr 6, 1001, Tirana, Albania / [www.aqscert.org](http://www.aqscert.org) info@aqscert.org



## CERTIFIKATË TRAJNIMI

Nr. i Certifikatës **AQS/T/S127972024**

Emri Mbiemri **Z. BESART ISMAILI**

Datëlindja **24-12-1996**

Mori pjesë në trajnimin me temë:

### **"Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD".**

Temat e trajtuara:

#### MODULI TEORIK:

- 1 - Aspektet rregullatore:
  - EN 16636:2015 "Shërbimet për menaxhimin e dëmtuesve – Kërkesat dhe kompetencat";
  - Dëmtuesit urbanë: Biologjia e dëmtuesve kryesorë;
  - Shënime mbi Entomologjinë.
- 2 - Nocionet për biologjinë e Insekteve:
  - Buburrecat: njohja, biologjia dhe sjellja në zinxhirin e furnizimit me ushqim
  - Mizat: biologjia dhe kontrolli
  - Mushkonjat: biologjia, sjellja, monitorimi dhe kontrolli
  - Insektet e shtërtrës: biologjia dhe kontrolli
  - Ektoparazitë të tjerë: rrigrat e pëllumbave dhe pleshtat – biologjia dhe kontrolli

#### MODULI PRAKTIK:

- 1 - Nocionet për biologjinë e brejtësve:
  - Brejtësit sinantropikë: njohja, biologjia dhe sjellja;
  - Brejtësit në zinxhirin e furnizimit ushqimor: monitorimi, korrigjimi i minjve dhe planet e kontrollit;
  - Përdorimi i produkteve të kontrollit të brejtësve;
  - Kontrolli ekologjik i brejtësve.
- 2 - Kontrolli i aktivitetëve:
  - Metodatat e kontrollit: inspektimi dhe monitorimi (Pest Control);
  - Teknikat e ndërhyrjes (insektet dhe brejtësit);
  - Procedurat e ndihmës së parë.
- 3 - Rregullat dhe procedurat për përdorimin e biocidëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve:
  - Vlerësimi i rrezikut;
  - Pajisjet mbrojtëse personale (veshja dhe zhveshja);
  - Mjetet dhe pajisjet;
  - Planifikimi i veprimtarisë;
  - Emergjencat dhe menaxhimi i mbetjeve.



For Certification Body

*Eriola Cuno*

Datat e trajnimit 31/07/2024 03/08/2024 Ore 32

Vendi i trajnimit Tirane, Shqiperi - Trajnimi i zhvilluar ON-LINE

Organizatorët e trajnimit AQSCERT "Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit"

Datat e lëshimit 03/08/2024 Data e skadencës 02/08/2027



DOC FO-A05-018

The validity of the certificate can be checked at <http://aqscert.org/en/#online-aqs-form> following the instructions that are reflected there.

Lector  AQSCERT

AQSCERT Sh.p.k. / Rruga Jusuf Vriani, Pallati 1, Nr 6, 1001, Tirana, Albania / [www.aqscert.org](http://www.aqscert.org) [info@aqscert.org](mailto:info@aqscert.org)

**Së pari, shkresa e AQS CERT sqaron pikërisht faktin që AK-ja e kishte vënë në dyshim: certifikatat janë lëshuar pas përfundimit me sukses të programit dhe jo vetëm për regjistrim ose pjesëmarrje formale. AK-ja nuk identifikon ndonjë të dhënë konkrete që e përgënjeshtrojnë këtë konfirmim. Përmendja se shkresa është shqyrtuar nuk mjafton kur përfundimi i saj thelbësor mbetet pa përgjigje.**

Përveç shkresës zyrtare, institucioni lëshues ofron mundësinë e verifikimit të certifikatave në regjistrin online, përmes faqes zyrtare <https://www.aqscert.org/certifikata-ime/>. Për krahasim me certifikatat e dorëzuara në ofertë, në vijim paraqiten pamjet e rezultateve të kërkimit për secilin person.

### PROVA – Verifikimi online i certifikatës së Florian Sylës në faqen zyrtare të AQS CERT

The screenshot shows the AQS CERT website interface. At the top, there is a navigation bar with links: FAQE KRYESORE, KUSH JEMI, SHERBIMET TONA, PUNONI ME NE, and KONTAKTO. The Albanian flag is also visible. The main content area has a dark blue background with white text. A white modal box is centered on the screen, displaying the verification results for Florian Sylë. The text in the modal box is as follows:

Name of the trained person : **FLORIAN SYLA**  
Birthdate: **28-03-03**  
Number of certificate: **AQS/T/s127962024**  
Title of training certificate: **"Kurs Trajnimi per kryerjen e Sherbimeve DDD".**  
Training date: **07-10/08/2024**  
Place of training: **Tirane, Shqiperi**  
Date of certificate issuance: **10-08-24**  
Expiration date: **09-08-27**

### PROVA – Verifikimi online i certifikatës së Besart Ismailit në faqen zyrtare të AQS CERT

The screenshot shows the AQS CERT website interface, similar to the previous one. The navigation bar and main content area are the same. A white modal box is centered on the screen, displaying the verification results for Besart Ismaili. The text in the modal box is as follows:

Name of the trained person : **BESART ISMAILI**  
Birthdate: **24-12-96**  
Number of certificate: **AQS/T/s127972024**  
Title of training certificate: **"Kurs Trajnimi per kryerjen e Sherbimeve DDD".**  
Training date: **07-10/08/2024**  
Place of training: **Tirane, Shqiperi**  
Date of certificate issuance: **10-08-24**  
Expiration date: **09-08-27**

Rezultatet e verifikimit online duhet të vlerësohen sipas të dhënave që shfaqin për certifikatat përkatëse, ndërsa **shkresa nr. 54 Prot., datë 02.09.2026**, sqaron përfundimin e trajnimit dhe përmbajtjen e programit. Këto prova duhen shqyrtuar së bashku me dokumentet e ofertës, duke dalluar verifikimin e autenticitetit dhe statusit të certifikatës nga vlerësimi i përmbushjes së kërkesës konkrete të tenderit.

**Së dyti, data e shkresës sqaruese duhet dalluar nga data e fitimit të kualifikimit.** Punonjësit, certifikatat dhe trajnimi mbeten të njëjtë. Sqarimi i një fakti paraekzistues nuk barazohet vetvetiu me ndryshim material të ofertës. AK-ja duhet të shpjegonte konkretisht cilin element të ri mendon se po i shtohet ofertës dhe pse konfirmimi i lëshuesit nuk lejohet të shërbejë për verifikimin e saj, duke zbatuar nenin 59 të LPP-së dhe nenin 38 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Në rastin konkret, shkresa e datës 02.09.2026 nuk dëshmon një trajnim të kryer pas afatit të ofertimit ajo është vetëm një shkresë zyrtare nga institucioni që ka lëshuar për të sqaruar se cka janë certifikatat dhe për të konfirmuar validitetin dhe kuptimin e tyre. Ajo konfirmon përmbajtjen dhe përfundimin e trajnimit të vitit 2024, për të cilin certifikatat ishin dorëzuar tashmë në ofertë. Prandaj, refuzimi i efektit të saj sqarues kërkon një arsyetim konkret që mungon në vendimin e AK-së.

**Së treti, AK-ja nuk tregon dispozitën e DT/NJK që ndalon formatin online ose kërkon një formulë të caktuar gjuhësore në certifikatë.** AQS CERT ka konfirmuar edhe komponentin praktik përmes demonstrimeve dhe shembujve praktikë. Nëse AK-ja e konsideron këtë të pamjaftueshëm, duhet ta lidhë vlerësimin me një kërkesë të publikuar dhe me një mangësi konkrete. Zbatimi i kriterëve të papublikuara cenon trajtimin e barabartë sipas nenit 7 të LPP-së dhe nenit 40.12 të Rregullores.

**Së katërti, faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër mbështesin aprovimin e pretendimit tonë dhe anulimin e eliminimit të ofertës së GOE-së sonë.** Certifikatat e dorëzuara me ofertë, të shqyrtuara së bashku me rezultatet e verifikimit online dhe shkresën zyrtare të AQS CERT nr. 54 Prot., datë 02.09.2026, mbështesin përmbushjen e kërkesës për trajnimin DDD. Shkresa e institucionit lëshues konfirmon përfundimin me sukses të programit dhe sqaron përmbajtjen e certifikatave ekzistuese, pa krijuar kualifikim të ri dhe pa ndryshuar ofertën e dorëzuar.

AK-ja, në vendimin refuzues të datës 07.09.2026, nuk ka paraqitur kundërgargument konkret që rrëzon këtë konfirmim dhe as ka identifikuar kërkesën e publikuar që mbetet e papërmbushur. Për rrjedhojë, konsiderojmë se mbajtja në fuqi e eliminimit mbi interpretimin e formulimit të certifikatave dhe formatin online të trajnimit është e pabazuar.

**Duke u mbështetur në të gjitha faktet, provat dhe argumentet e mësipërme, kërkojmë nga OSHP-ja që ta aprovojë Pretendimin nr. 1 si të bazuar, të konstatojë se arsyeja e eliminimit lidhur me certifikatat DDD nuk qëndron dhe të anulojë vendimin e AK-së për eliminimin e ofertës së GOE-së sonë mbi këtë bazë, si dhe pjesën përkatëse të vendimit refuzues të datës 07.09.2026.** Kërkojmë që AK-ja të detyrohet t'i vlerësojë certifikatat sipas kërkesës së publikuar në Dosjen e Tenderit dhe provave të paraqitura, duke e trajtuar GOE-në tonë si përmbushëse të kësaj kërkesë.

## **Pretendimi Nr.2**

### **Mosrespektimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400**

Autoriteti Kontraktues është obliguar me pikën 3 të Vendimit nr. 2026/0400 që, në afat prej dhjetë (10) ditësh, ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Vetë Paneli Shqyrtues ka përcaktuar se, në rast të mosrespektimit të këtij obligimi, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj Autoritetit Kontraktues për mosrespektim të vendimit, në përputhje me nenin 131 të LPP-së.

Megjithatë, edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga OSHP, aktiviteti i prokurimit ka vazhduar të mbetet pa u proceduar në mënyrë të rregullt dhe pa u reflektuar veprimet e kërkuara nga Vendimi nr. 2026/0400. “Nga dokumentacioni në dispozicion të OE-së nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues e ka përmbushur këtë obligim brenda afatit të përcaktuar nga Paneli Shqyrtues.”

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues të dëshmojë nëse dhe në cilën datë e ka informuar OSHP-në lidhur me veprimet e ndërmarra brenda afatit dhjetëditor të përcaktuar në pikën 3 të vendimit.

Nëse një njoftim i tillë nuk është bërë brenda afatit, atëherë kemi të bëjmë me mosrespektim të drejtpërdrejtë të Vendimit nr. 2026/0400, për të cilin vetë OSHP ka paralajmëruar ndërmarrjen e masave sipas nenit 131 të LPP-së.

### **Pergjigja e AK per pretendimin nr.2**

Zbatimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400 Parashtruesi pretendon se Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400 dhe kërkon dëshmi lidhur me veprimet e ndërmarra pas këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0400 është marrë në konsideratë gjatë procedurës së rivlerësimit dhe se veprimet e ndërmarra pas pranimit të këtij vendimi janë kryer në kuadër të kompetencave dhe obligimeve të Autoritetit Kontraktues.

Fakti që pas rivlerësimit Autoriteti Kontraktues ka arritur në të njëjtin rezultat nuk nënkupton në vetvete se Vendimi i OSHP-së nuk është zbatuar.

Vendimi i OSHP-së nuk e obligon domosdoshmërisht Autoritetin Kontraktues që të ndryshojë rezultatit përfundimtar të procedurës, por obligon atë që çështjet e përcaktuara në vendimin përkatës t'i shqyrtojë dhe t'i trajtojë në pajtim me ligjin dhe dokumentet e tenderit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk janë paraqitur prova konkrete të cilat dëshmojnë se rivlerësimi është kryer në kundërshtim me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400.

## Kundërshtimi ynë:

AK-ja nuk i është përgjigjur pretendimit tonë konkret: **a e ka informuar OSHP-në brenda afatit dhjetëditor dhe ku është dëshmia e këtij informimi?** Në vendimin refuzues të datës 07.09.2026 nuk është identifikuar data e raportimit, shkresa përcjellëse apo dëshmia e dërgimit dhe pranimi të saj.

Pika 3 e dispozitivit të **Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400, datë 22.07.2026**, përcakton shprehimisht:

*"Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP."*

Ky është **detyrim i shprehur për informimin e OSHP-së brenda afatit të caktuar**. Deklarimi i AK-së se vendimi është "marrë në konsideratë" dhe se rivlerësimi mund të prodhojë të njëjtin rezultat nuk dëshmon përmbushjen e këtij detyrimi dhe nuk i përgjigjet kërkesës sonë.

Me aktin e datës 23.07.2026, vetë AK-ja konfirmon se vendimin e OSHP-së e ka pranuar më 22.07.2026. Anulimi i B58 të mëparshëm dëshmon një veprim të ndërmarrë, por nuk provon se për këtë dhe veprimet e tjera është informuar OSHP-ja brenda afatit të urdhëruar.

Nëse raportimi është kryer, AK-ja duhet të paraqesë shkresën dhe dëshminë përkatëse. **Mungesa e këtyre dokumenteve në përgjigjen e AK-së nuk mund të zëvendësohet me pretendimin se ne nuk kemi paraqitur prova**, kur dëshmia e raportimit administrohet nga vetë AK-ja dhe OSHP-ja.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP-ja që të verifikojë regjistrin e saj dhe të kërkojë nga AK-ja provën e raportimit. **Nëse konstatohet se informimi nuk është kryer brenda afatit dhjetëditor, kërkojmë që Pretendimi nr. 2 të aprovet si i bazuar, të konstatohet mosrespektimi i pikës 3 të Vendimit nr. 2026/0400 dhe të vlerësohet ndërmarrja e masave sipas nenit 131 të LPP-së, siç parashikohet shprehimisht në këtë vendim.**

### ***Pretendimi Nr.3***

***Përpyjekja e juaj për krijimin e kushteve për eliminimin e tonë përmes moskërkimit të zgjatjes së validitetit dhe sigurimit të tenderit***

Kundërshtojmë fuqishëm mosveprimin tuaj lidhur me **validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit**, i cili objektivisht ka krijuar kushtet që më pas ne të mund të eliminohej për shkak të skadimit të tyre.

Sipas **nenit 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, kur procesi nuk mund të përfundojë brenda validitetit të ofertave, **AK duhet të kërkojë me shkrim, para skadimit, zgjatjen e validitetit të tenderëve**. Neni 30.5 përcakton se njëkohësisht duhet të kërkohet edhe **zgjatja e validitetit të sigurimit të tenderit**, ndërsa neni 30.6 parasheh eliminimin vetëm për OE-në që, pasi i kërkohet zgjatja, vendos të mos e zgjasë atë.

Ju si AK **nuk na keni dërguar një kërkesë të tillë**, pavarësisht se aktiviteti vazhdonte dhe ishte kthyer në rivlerësim nga OSHP. KRPP ka sqaruar shprehimisht se AK duhet ta kërkojë zgjatjen **edhe kur**

**aktiviteti është në pezullim për shkak të OSHP-së, dhe moszbatimin e nenit 30.4 e klasifikon si shkelje të rëndë.**

Përkundër mosveprimit tuaj, **OE-ja jonë ka vepruar vetë: më 31.07.2026**, para skadimit, ju kemi dërguar kërkesë urgjente për zgjatjen dhe më pas konfirmimin me shkrim se validitetin e ofertës e zgjasim edhe për **60 ditë, nga 03.08.2026 deri më 01.10.2026**. Gjithashtu kemi siguruar edhe sigurimin e tenderit për **90 ditë**, të lëshuar më 01.09.2026.

Kjo sjellje e juaja është edhe më shqetësuese kur merret parasysh **neni 57 i LPP-së**, i cili rregullon sigurimin e tenderit dhe kërkon që kushtet për sigurimin të aplikohen njësoj ndaj tenderuesve, si dhe **neni 7 i LPP-së**, që imponon trajtim të barabartë dhe jodiskriminues.

Prandaj, çdo përpjekje e Juaj si Autoritet Kontraktues për të krijuar apo gjetur arsye shtesë për eliminimin e tone, duke u mbështetur në pasoja që kanë ardhur nga vetë mosveprimi procedural i AK-së, është joproporcionale dhe në kundërshtim me frymën dhe kërkesat e Rregullores për Prokurimin Publik.

### **Pergjigja e Autoritetit Kontraktues per pretendimin Nr.3:**

Parashtruesi pretendon se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar në kohë zgjatjen e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit, duke iu referuar nenit 30 të Rregullores Nr. 001/2022.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit rezulton se çështja e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit është trajtuar në kuadër të procedurës dhe se dokumentacioni përkatës është administruar në dosjen e aktivitetit të prokurimit.

Fakti se më 31.07.2026 është paraqitur dokumentacion lidhur me zgjatjen e validitetit të ofertës nuk dëshmon, në vetvete, se oferta ka qenë e pavlefshme ose se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat përkatëse.

Parashtruesi nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se në momentin relevant oferta e tij ose siguri i tenderit nuk kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në legjislacionin në fuqi

### **Kundërshtimi ynë:**

AK-ja e zhvendos padrejtësisht shqyrtimin nga **mosveprimi i saj procedural** te vlefshmëria e ofertës sonë. Pretendimi ynë ka të bëjë me mosdërgimin e kërkesës për zgjatjen e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit gjatë vazhdimit të procedurës. Prandaj, arsyetimi se ne nuk kemi provuar pavlefshmërinë e ofertës sonë nuk i përgjigjet kundërshtimit të ngritur.

Për ta rrëzuar pretendimin tonë, AK-ja duhej të identifikonte **kërkesën për zgjatje, datën e dërgimit, dëshminë e pranimit dhe mënyrën e trajtimit të ofertuesve të tjerë**. Vendimi refuzues nuk përmban këto të dhëna. Pohimi se dokumentacioni është administruar në dosje nuk dëshmon se AK-ja e ka përmbushur detyrimin për ta kërkuar zgjatjen.

Komunikimet tona të datës **31.07.2026** dëshmojnë iniciativën e GOE-së për vazhdimin e ofertës gjatë procedurës. **Veprimet e ndërmarra nga ne nuk e zëvendësojnë dhe nuk e shuajnë detyrimin e AK-së**

për administrimin e këtij procesi sipas nenit 30 të Rregullores për Prokurimin Publik. Përmbushja e këtij detyrimi duhet të vlerësohet më vete, pavarësisht iniciativës së ofertuesit.

Për këtë arsye, kërkojmë që OSHP-ja të administrojë komunikimet dhe kërkesat e AK-së për zgjatjen ndaj të gjithë ofertuesve, së bashku me dëshmitë elektronike të dërgimit dhe pranimi. Ky kontroll duhet të përcaktojë nëse AK-ja ka vepruar sipas detyrimeve të saj dhe nëse ka zbatuar trajtim të barabartë, në përputhje me nenet 7 dhe 57 të LPP-së.

Nevoja për këtë verifikim përforcohet edhe nga përgjigjet ndaj kërkesës sonë për qasje në dokumente të datës **31.08.2026** dhe parashtrësës **“Qartësim dhe plotësim i kërkesës për qasje në dokumentet e rivlerësimit”**, të së njëjtës datë. Përmes njoftimit të datës **31.08.2026** dhe përgjigjes së datës **01.09.2026**, AK-ja ka deklaruar:

*“Autoriteti Kontraktues ju njofton se nuk ka dokumentacion të ri për t’ju dorëzuar në përgjigje të kërkesës suaj të datës 31.08.2026, pasi dokumentacioni për të cilin kërkohej qasje nuk ekziston si dokumentacion i ri dhe dokumentet ekzistuese ju janë vënë në dispozicion në teresi dhe pa censurim”.*

Megjithëse AK-ja deklaron se rivlerësimi është mbështetur në dokumentacionin ekzistues dhe se nuk ka dokumentacion të ri për të na dorëzuar, nga data **22.07.2026** deri më **31.08.2026** kanë kaluar **40 ditë**, pas të cilave është arritur përsëri në të njëjtin rezultat. AK-ja nuk ka shpjeguar konkretisht cilat veprime e kanë kërkuar këtë kohëzgjatje dhe si është administruar, gjatë kësaj periudhe, nevoja për zgjatjen e validitetit dhe sigurimit të tenderit.

Të marra së bashku, këto rrethana ngrenë dyshimin tonë se **nxjerrja e vendimit pikërisht më 31.08.2026, krahas mosdërgimit të kërkesës për zgjatje, mund të ketë synuar krijimin e paqartësisë dhe shpërqendrimin procedural, me mundësinë që një lëshim i ofertuesit të përdorej si arsye shtesë eliminimi**. Ky dyshim kërkon verifikim të kronologjisë dhe komunikimeve nga OSHP-ja; nuk paraqitet si qëllim tashmë i provuar.

Kërkojmë që OSHP-ja ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar dhe të konstatojë mosveprimin procedural të AK-së, nëse nga dosja dhe regjistrat elektronikë nuk provohet dërgimi i kërkesave përkatëse sipas nenit 30 të Rregullores.

#### ***Pretendimi Nr.4***

***Mosrespektimi i drejtpërdrejtë dhe përmbajtësor i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400 lidhur me kriterin minimal prej 40,000.00 € të kontratave të natyrës së ngjashme***

Ju si Autoritet Kontraktues, edhe pas **Vendimit nr. 2026/0400 të OSHP-së**, gjatë rivlerësimit keni rekomanduar përsëri për kontratë të njëjtin Operator Ekonomik, ndonëse pikërisht çështja e përmbushjes së kriterit minimal prej **40,000.00 € të kontratave të natyrës së ngjashme** është shqyrtuar në procedurën pranë OSHP-së dhe për të janë dhënë konstatime konkrete nga Eksperti Shqyrtues.

Në këtë fazë nuk kemi më të bëjmë me një pretendim të ri të GOE-së sonë dhe as me një interpretim tonin kundër interpretimit të Autoritetit Kontraktues. Kemi të bëjmë me një çështje që është

**shqyrtuar, analizuar dhe administruar në procedurën ankimore nr. 2026/0400**, pas së cilës vendimi i AK-së është anuluar dhe aktiviteti është kthyer në rivlerësim.

**Ekspteri Shqyrtues ka konstatuar konkretisht se OE i rekomanduar nuk e arrin kriterin prej 40,000.00 €**

Ekspteri Shqyrtues, pas analizimit të Listës së Kontratave dhe dokumenteve mbështetëse të OE-së së rekomanduar, ka konstatuar se një pjesë e kontratave janë jashtë periudhës trevjeçare të kërkuar, një kontratë nuk është fare e natyrës së ngjashme me objektin e këtij prokurimi dhe për kontrata të tjera ekzistojnë mospërputhje ndërmjet Listës së Kontratave dhe referencave mbështetëse.

Pas përjashtimit të kontratave që nuk plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit, Ekspteri ka konstatuar shprehimisht:

**“vlera e kontratave të natyrës së ngjashme në fushën e DDD-së arrin në shumën prej vetëm 15,214.97 €, e cila është dukshëm më e ulët se vlera minimale prej 40,000.00 € e kërkuar nga AK.”**

Pra gjendja faktike e konstatuar në procedurën e OSHP-së është e qartë: **Kërkesa minimale e DT/NJK: 40,000.00 € ndersa Vlera valide e konstatuar nga Ekspteri: 15,214.97 €**

Kjo nuk është një mospërputhje formale apo marginale. OE i rekomanduar, sipas analizës së Eksptetit Shqyrtues, dëshmon vetëm me pak se gjysmen e kërkuar në DT, **Ekspteri ka konstatuar shkelje konkrete të nenit 59.4 të LPP-së**

Ekspteri nuk është kufizuar vetëm në evidentimin e shumës prej 15,214.97 €. Ai ka nxjerrë edhe përfundim të drejtpërdrejtë juridik ndaj veprimit tuaj si Autoritet Kontraktues:

**“eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së.”**

Neni 59.4, siç citohet edhe në vetë Raportin e Eksptetit, përcakton:

**“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”**

Në rastin konkret kriteri ishte **40,000.00 €**, ndërsa vlera e dëshmuar sipas Eksptetit është **15,214.97 €**. Pra, Ekspteri i OSHP-së ka konstatuar jo vetëm mangësinë faktike, por edhe se **Ju e keni konsideruar të përgjegjshëm një tender në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së.**

Ekspteri Shqyrtues i është referuar në mënyrë specifike edhe **Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, pika 10**, duke konstatuar se në rastet kur Lista e Kontratave të realizuara nuk e përmbush vlerën minimale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit: **“AK duhet ta refuzojë tenderin pa kërkuar informacion ose dokumentacion shtesë.”**

Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme. Në procedurën nr. 2026/0400 është konstatuar: **kriteri nuk plotësohet;**

**vlera valide është vetëm 15,214.97 €;**

**AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së;**

**dhe Udhëzuesi nr. 001/2023 parasheh refuzimin e tenderit kur lista nuk arrin vlerën minimale.**

Megjithatë, pas kthimit në rivlerësim, **Ju e rekomandoni përsëri të njëjtin OE për kontratë.** Kjo nuk paraqet korrigjim të shkeljes së konstatuar. Paraqet **përsëritje të saj.**

**Paneli Shqyrtues ka sqaruar qartë mënyrën se si e ka trajtuar Raportin e Ekspertit**

Për të mos lënë hapësirë që gjatë këtij rivlerësimi Raporti i Ekspertit të trajtohet si një dokument pa efekt, duhet parë pikërisht arsyetimi i Panelit Shqyrtues. Paneli ka konstatuar se ka marrë në konsideratë **të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK-së dhe Raportin e Ekspertit Shqyrtues.**

Më pas Paneli deklaron:

**“Paneli nuk i mbështet në tërësi shpjegimet e ekspertit shqyrtues...”**

dhe menjëherë sqaron mënyrën se si do të procedojë:

**“Paneli Shqyrtues do të ndalet në shqyrtim vetëm në pjesën e pretendimeve ankimore për të cilat nuk e mbështet ekspertin shqyrtues.”**

Ky formulim është vendimtar. Sa i përket konstatimit për kriterin prej **40,000.00 €**, Paneli në arsyetimin e tij **nuk e ka identifikuar këtë konstatim si një prej pjesëve ku nuk e mbështet Ekspertin Shqyrtues.**

Nuk e ka rrëzuar shumën prej **15,214.97 €**. Nuk ka konstatuar se kontratat e përjashtuara nga Eksperti duhet të llogariten. Nuk ka konstatuar se OE i rekomanduar e arrin kriterin prej 40,000.00 €. Dhe nuk ka ndryshuar konstatimin e Ekspertit se AK nuk kishte vepruar në përputhje me **nenin 59.4 të LPP-së**. **Përfundimisht, Paneli e aprovoi ankesën tonë si të bazuar dhe anuloi vendimin tuaj.**

Pas administrimit të të gjitha këtyre provave dhe konstatimeve, Paneli Shqyrtues me Vendimin nr. **2026/0400** ka vendosur:

**“Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE BEST D.D.D. SH.P.K.”**

dhe:

**“Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA E VUSHTRRISË, ndërkaq ky AP kthehet në Rivlerësim.”**

Prandaj, kthimi në rivlerësim **nuk ka qenë autorizim për Ju që ta përsëritni të njëjtin vlerësim dhe të arrini përsëri në të njëjtin rezultat duke mos adresuar konstatimet e procedurës nr. 2026/0400.** Rivlerësimi është dashur të shërbejë për **korrigjimin e shkeljeve të konstatuara.**

Përndryshe, vendimi i OSHP-së do të reduktohej në një formalitet pa efekt juridik: AK anulon formalisht vendimin e parë, e quan procesin e ardhshëm “rivlerësim”, por më pas vazhdon të konsiderojë të përgjegjshëm të njëjtin OE në pikën ku Eksperti kishte konstatuar mosplotësimin kriterit.

**Kjo nuk është zbatim i Vendimit nr. 2026/0400. Është mosrespektim përmbajtësor i tij.**

**Rivlerësimi formal nuk e shëron mosrespektimin e Vendimit të OSHP-së**

Fakti që Ju formalisht e keni kthyer aktivitetin në Komision Vlerësues nuk është i mjaftueshëm për të pretenduar se Vendimi i OSHP-së është zbatuar. Vendimi duhet të respektohet **në përmbajtje**, jo vetëm në formë.

Në rastin konkret kemi këtë sekuencë të qartë:

**Eksperti Shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar ka vetëm 15,214.97 € nga minimumi 40,000.00 €;**

**Eksperti konstaton se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së;**

**Eksperti i referohet pikës 10 të Udhëzuesit nr. 001/2023, sipas së cilës tenderi që nuk e arrin minimumin duhet të refuzohet pa kërkuar dokumentacion shtesë;**

**Paneli aprovon ankesën tonë si të bazuar dhe anulon vendimin e AK-së;**

dhe, megjithatë,

**Ju pas “rivlerësimit” rekomandoni përsëri të njëjtin OE për kontratë.**

Në këto rrethana, rezultati i rivlerësimit tuaj është në **kundërshtim të drejtpërdrejtë me konstatimin material që duhej të adresohet pas Vendimit nr. 2026/0400**. Ju nuk mund ta konsideroni të zbatuar një vendim të OSHP-së vetëm sepse keni përsëritur procedurën administrative, ndërkohë që **shkelja konkrete e konstatuar në procedurën e OSHP-së vazhdon të prodhojë të njëjtin rezultat**.

Për këto arsye, kërkojmë që **Pretendimi nr. 5 të aprovohet në tërësi si i bazuar dhe të konstatohet se Autoriteti Kontraktues, gjatë rivlerësimit, nuk e ka respektuar në mënyrë përmbajtësore Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400**, duke e konsideruar përsëri të përgjegjshëm dhe duke e rekomanduar për kontratë OE-në për të cilin në procedurën shqyrtuese është konstatuar se dëshmon vetëm **15,214.97 €**, kundrejt minimumit prej **40,000.00 €**.

Kërkojmë që ky kriter të trajtohet në përputhje me **konstatimet e administruara në procedurën nr. 2026/0400, nenin 59.4 të LPP-së, Dosjen e Tenderit dhe pikën 10 të Udhëzuesit nr. 001/2023**, dhe tenderi i OE-së së rekomanduar të mos konsiderohet i përgjegjshëm përderisa nuk plotëson kriterin minimal të përcaktuar në DT/NJK.

#### **Pergjigja e Autoritetit Kontraktues per pretendimin Nr.4:**

Parashtruesi pretendon se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur kriterin minimal prej 40,000.00 € për kontratat e natyrës së ngjashme.

Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i referohet Raportit të Ekspertit Shqyrtues dhe shumës prej 15,214.97 €.

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik dhe kërkesave të përcaktuara në DT/NJK, vlerëson se dokumentacioni i administruar dëshmon përmbushjen e kriterit të kërkuar, në përputhje me mënyrën e përcaktuar në dokumentet e tenderit për dëshmimin e përvojës së ngjashme.

Vlera e përmendur nga parashtruesi prej 15,214.97 € nuk mund të konsiderohet e shkëputur nga tërësia e dokumenteve dhe kontratave të paraqitura nga Operatori Ekonomik, pa marrë në konsideratë dokumentacionin tjetër relevant të dorëzuar për dëshmimin e kriterit.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm në dosjen e tenderit dhe nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për të konstatuar se Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk e ka përmbushur kriterin minimal prej 40,000.00 €

#### **Kundershtimi yne:**

Kundërshtojmë përgjigjen e AK-së sepse ajo nuk rrëzon me prova dhe arsyetim konkret konstatimet e Ekspertit Shqyrtues për kriterin minimal prej **40.000,00 € të kontratave të natyrës së ngjashme**. Referimi i përgjithshëm të “tërësia e dokumenteve” nuk tregon cilat kontrata janë pranuar, cilat vlera janë llogaritur dhe si është arritur minimumi i kërkuar.

**Së pari, eksperti e ka shqyrtuar këtë çështje dhe ka identifikuar mangësi konkrete.** Në pjesën “Përgjigja lidhur me Pretendimin nr. 3.8”, Raporti\_Ekspertit\_2026 0400.pdf I datës 06/07/2026 përcakton:

“Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i tenderuesit ankues është pjesërisht i bazuar.”

Më pas, eksperti shpjegon bazën faktike të këtij vlerësimi:

*“Nga analiza e kontratave të kontestuara rezulton se një pjesë e tyre janë jashtë periudhës trevjeçare të kërkuar nga Dosja e Tenderit, një kontratë nuk është e natyrës së ngjashme me objektin e prokurimit, ndërsa për disa kontrata të tjera janë evidentuar mospërputhje ndërmjet të dhënave të paraqitura në Listën e Kontratave dhe referencave mbështetëse.”* Cituar nga [Raporti i Ekspertit Shqyrtues për çështjen nr. 2026/0400, datë 06.07.2026](#)

Pra, raporti identifikon tri çështje që kërkonin përgjigje gjatë rivlerësimit: **kontratat jashtë periudhës së kërkuar, kontratën që nuk është e natyrës së ngjashme dhe mospërputhjet ndërmjet listës dhe referencave.** Në vendimin refuzues të datës 07.09.2026, AK-ja nuk shpjegon si i ka trajtuar këto mangësi dhe mbi çfarë prove ka vendosur t’i pranojë kontratat e kontestuara.

**Së dyti, shuma 15.214,97 € është përfundim i shprehur i ekspertit, i lidhur me filtrimin e kontratave sipas kërkesave të dosjes.** Raporti thotë:

*“Sipas vlerësimit të ekspertit shqyrtues, pas përjashtimit të kontratave që nuk i plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit, vlera e kontratave të natyrës së ngjashme në fushën e DDD-së, të realizuara dhe të përfunduara brenda tre (3) viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë dhe të dëshmuara me referenca valide, arrin në shumën prej vetëm 15,214.97 €, e cila është dukshëm më e ulët se vlera minimale prej 40,000.00 € e kërkuar nga AK.”* Cituar nga [Raporti i Ekspertit Shqyrtues për çështjen nr. 2026/0400, datë 06.07.2026](#)

Ky formulim e kundërshton përgjigjen e AK-së se shuma nuk mund të merret e shkëputur nga dokumentacioni. **Eksperti e paraqet shumën pikërisht si rezultat të analizës së dokumentacionit dhe përjashtimit të kontratave që nuk plotësojnë kërkesat.** Nëse AK-ja konsideron se kjo analizë është e gabuar, ajo duhet të identifikojë gabimin dhe të paraqesë llogaritjen e saj alternative. Vendimi refuzues nuk e bën këtë.

**Së treti, raporti përcakton konkretisht analizën që AK-ja duhej të kryente.** Eksperti shprehet:

*“Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se AK është dashur të kryejë një analizë dhe verifikim të detajuar të secilës kontratë të paraqitur, me qëllim të konstatimit nëse tenderuesi i rekomanduar për kontratë, pas përjashtimit të kontratave që nuk përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit, vazhdon të përmbushë kriterin minimal të përvojës profesionale, përkatësisht realizimin e kontratave të natyrës*

së ngjashme në vlerën jo më pak se 40,000.00 €." Cituar nga [Raporti i Ekspertit Shqyrtues për çështjen nr. 2026/0400, datë 06.07.2026](#)

Prandaj, nga rivlerësimi duhej të rezultonte një analizë e kontrollueshme **për secilën kontratë**, me identifikimin e objektit, periudhës së realizimit, përfundimit, vlerës së pranuar dhe referencës mbështetëse. Përgjigjja se dokumentacioni në tërësi e dëshmon kriterin nuk e zëvendëson verifikimin e detajuar të kërkuar në raport.

AK-ja duhej të tregonte cilat kontrata i ka përjashtuar, cilat i ka pranuar dhe sa është shuma përfundimtare pas këtij shqyrtimi. Pa këto të dhëna, përfundimi se pragu 40.000,00 € është plotësuar mbetet i pambështetur në arsyetimin e vendimit.

**Së katërti, eksperti ka konstatuar shprehimisht mospërputhje me nenin 59.4 të LPP-së.** Raporti përcakton:

"Në bazë të sa u tha më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së, sipas të cilit:

'Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.'" Cituar nga [Raporti i Ekspertit Shqyrtues për çështjen nr. 2026/0400, datë 06.07.2026](#)

Përballë këtij konstatimi, AK-ja nuk mund të mjaftohet me pohimin se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për të konstatuar mosplotësimin e kriterit. **Përgjegjshmëria kërkon që përmbushja e kriterit të dëshmohet pozitivisht me dokumentet përkatëse.** Vendimi refuzues duhej të shpjegonte mbi çfarë provash është tejkaluar mangësia e konstatuar nga eksperti.

**Së pesti, eksperti e ka trajtuar edhe pasojën e mosplotësimit të vlerës minimale, duke iu referuar Udhëzuesit nr. 001/2023:**

"Gjithashtu, bazuar në Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, përkatësisht pikën 10, e cila rregullon sqarimin e tenderëve gjatë procesit të vlerësimit, në rastet kur lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesën minimale të vlerës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit, AK duhet ta refuzojë tenderin pa kërkuar informacion ose dokumentacion shtesë."

Cituar nga [Raporti i Ekspertit Shqyrtues për çështjen nr. 2026/0400, datë 06.07.2026](#)

Në tabelën përkatëse të raportit, për problemin e listës që nuk përmbush vlerën minimale, udhëzimi është:

| Problemi                                                                                           | Si te veprohet?                                     | Neni i LPP-se |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|---------------|
| Lista e kontratave te realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale te vlerës se përcaktuar | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm | 69            |

Screenshot nga [Raporti i Ekspertit Shqyrtues për çështjen nr. 2026/0400, datë 06.07.2026](#) faqe 55

AK-ja nuk ka shpjeguar pse ky trajtim nuk zbatohet në rastin konkret dhe cilat kontrata të pranueshme e bëjnë të përmbushur minimumin. Referimi i përgjithshëm te dokumentacioni ekzistues nuk është përgjigje ndaj këtij konstatimi.

**Së gjashti, përfundimi i raportit për këtë kriter është i drejtpërdrejtë:**

*“Në rastin konkret, nga analiza e dokumentacionit rezulton se, edhe pas përjashtimit të kontratave që nuk plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit, tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk arrin të dëshmojë përmbushjen e kriterit minimal për përvojë të ngjashme në vlerën prej 40,000.00 €. Për këtë arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues duhet ta rivlerësojë këtë kriter në përputhje me dispozitat e LPP-së, Dosjen e Tenderit dhe Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik.”* Cituar nga [Raporti i Ekspertit Shqyrtues për çështjen nr. 2026/0400, datë 06.07.2026](#)

Kështu, raporti jo vetëm evidenton mosarritjen e minimumit, por kërkon rivlerësimin e këtij kriteri sipas dokumenteve dhe dispozitave përkatëse. Pas kthimit të aktivitetit në rivlerësim me Vendimin e OSHP-së nr. **2026/0400, datë 22.07.2026**, AK-ja duhej të demonstronte konkretisht si e kishte kryer këtë shqyrtim. **Rekomandimi i përsëritur i të njëjtit OE, pa shpjeguar si janë zgjidhur mangësitë e identifikuar, nuk e rrëzon pretendimin tonë.**

Për këto arsye, **kërkojmë nga OSHP-ja ta aprovojë Pretendimin nr. 4 si të bazuar dhe të anulojë rekomandimin për kontratë të datës 31.08.2026**, duke marrë parasysh konstatimet e cituara të ekspertit sipas Raporti\_Ekspertit\_2026\_0400 I datës 06.07.2026 si dhe Vendimi\_2026\_0400 I datës 22.07.2026 ku pajtohet me mendimin e ekspertit për ket pike dhe mungesën e një kundëranalize të dokumentuar nga AK-ja. **Kërkojmë që përmbushja e kriterit të përcaktohet mbi kontratat dhe referencat e pranueshme dhe që oferta e OE-së së rekomanduar të mos konsiderohet e përgjegjshme sepse nuk dëshmon minimumin prej 40.000,00 € të kërkuar në Dosjen e Tenderit.**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Best D.D.D. SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve" me numër të prokurimit: "644-26-3046-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E VUSHTRISË

### Përgjigjja lidhur me Pretendimin nr. 3.8

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i tenderuesit ankues është pjesërisht i bazuar.

Nga analiza e kontratave të kontestuara rezulton se një pjesë e tyre janë jashtë periudhës trevjeçare të kërkuar nga Dosja e Tenderit, një kontratë nuk është e natyrës së ngjashme me objektin e prokurimit, ndërsa për disa kontrata të tjera janë evidentuar mospërputhje ndërmjet të dhënave të paraqitura në Listën e Kontratave dhe referencave mbështetëse.

Sipas vlerësimit të ekspertit shqyrtues, pas përjashtimit të kontratave që nuk i plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit, vlera e kontratave të natyrës së ngjashme në fushën e DDD-së, të realizuara dhe të përfunduara brenda tre (3) viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë dhe të dëshmuara me referenca valide, arrin në shumën prej vetëm 15,214.97 €, e cila është dukshëm më e ulët se vlera minimale prej 40,000.00 € e kërkuar nga AK.

Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se AK është dashur të kryejë një analizë dhe verifikim të detajuar të secilës kontratë të paraqitur, me qëllim të konstatimit nëse tenderuesi i rekomanduar për kontratë, pas përjashtimit të kontratave që nuk përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit, vazhdon të përmbushë kriterin minimal të përvojës profesionale, përkatësisht realizimin e kontratave të natyrës së ngjashme në vlerën jo më pak se 40,000.00 €.

Në bazë të sa u tha më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së, sipas të cilit:

*"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."*

Gjithashtu, bazuar në Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, përkatësisht pikën 10, e cila rregullon sqarimin e tenderëve gjatë procesit të vlerësimit, në rastet kur lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesën minimale të vlerës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit, AK duhet ta refuzojë tenderin pa kërkuar informacion ose dokumentacion shtesë.

| Problemi                                                                                           | Si të veprohet?                                     | Neni i LPP-se |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|---------------|
| Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 69            |

Në rastin konkret, nga analiza e dokumentacionit rezulton se, edhe pas përjashtimit të kontratave që nuk plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit, tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk arrin të dëshmojë përmbushjen e kriterit minimal për përvojë të ngjashme në

## **Pretendimi Nr.5**

**AK përsërit të njëjtin rezultat edhe pas anulimit nga OSHP dhe konstatimit se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret – mosrespektim përmbajtësor i Vendimit nr. 2026/0400**

Ju si Autoritet Kontraktues keni deklaruar zyrtarisht se pas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400, Komisioni profesional ka kryer **rivlerësimin “duke u bazuar në dokumentacionin ekzistues të aktivitetit të prokurimit”** dhe se ky proces **“nuk ka rezultuar me krijimin, dorëzimin, pranimin apo administrimin e ndonjë dokumenti të ri nga ana e Operatorëve Ekonomikë.”**

Kjo do të thotë se rivlerësimi është zhvilluar mbi të njëjtën gjendje dokumentare mbi të cilën OSHP e kishte konsideruar OE, S.V. “Veterina” si te pa përgjegjshme dhe ekishte anuluar vendimin tuaj dhe e kishte kthyer aktivitetin në rivlerësim.

Megjithatë, në B58 të datës **31.08.2026**, Ju deklaroni se keni vepruar “konform Vendimit 2026/0400”, por përsëri rekomandoni për kontratë të njëjtin OE, S.V. “Veterina”, me vlerë **51,464.00 €**.

Këtu qëndron problemi thelbësor:

- **dokumentacioni nuk ka ndryshuar;**
- **OSHP e kishte anuluar vlerësimin e mëparshëm;**
- **gjatë rivlerësimit nuk janë administruar prova të reja nga OE-të;**
- **megjithatë AK ka prodhuar përsëri të njëjtin rezultat duke rekomanduar per kontrate oe e papergjegjshëm sipas Vendimit OSHP-së nr. 2026/0400.**

Në këto rrethana, nuk mjafton që procesi të quhet formalisht “rivlerësim”. Rivlerësimi duhej të demonstronte në mënyrë konkrete se si janë adresuar konstatimet dhe mangësitë që çuan në anulimin e vendimit të parë.

Përderisa kjo nuk rezulton nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, kemi arsye serioze të konstatojmë se është kryer **rivlerësim formal dhe jo përmbajtësor**, duke përsëritur vlerësimin e mëparshëm mbi të njëjtën bazë dokumentare.

Andaj, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të gabuar dhe nuk e ka zbatuar në mënyrë efektive dhe përmbajtësore Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400.

### **Pergjigja e Autoritetit Kontraktues per pretendimin Nr.5:**

Parashtruesi pretendon se, pavarësisht Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400, Autoriteti Kontraktues ka arritur përsëri në të njëjtin rezultat dhe ka rekomanduar të njëjtin Operator Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kthimi i aktivitetit në rivlerësim nuk nënkupton detyrimisht ndryshimin e rezultatit përfundimtar.

Rivlerësimi nënkupton rishqyrtimin e ofertave dhe çështjeve të përcaktuara në vendimin përkatës, në pajtim me kërkesat e DT/NJK dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Në rastin konkret, fakti se pas rivlerësimit është arritur në të njëjtin rezultat nuk përbën shkelje nëse rezultati është mbështetur në ekzaminimin dhe vlerësimin e dokumentacionit dhe në arsyetimin përkatës.

Parashtruesi nuk ka paraqitur prova konkrete që dëshmojnë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë arbitrare ose se rivlerësimi është kryer pa marrë në konsideratë Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400

## Kundershtimi yne:

AK-ja e paraqet pretendimin tonë sikur kundërshtojmë vetëm rekomandimin e të njëjtit Operator Ekonomik. **Pretendimi ynë është se gjatë rivlerësimit nuk është shpjeguar dhe dokumentuar se si janë adresuar mangësitë konkrete të trajtuara në procedurën pranë OSHP-së.** Përgjigja se rivlerësimi nuk nënkupton domosdoshmërisht ndryshimin e rezultatit nuk e zgjidh këtë çështje.

Në vendimin refuzues të datës **07.09.2026**, vetë AK-ja e lidh ligjshmërinë e rezultatit të përsëritur me ekzaminimin e dokumentacionit dhe arsyetimin përkatës. Megjithatë, **nuk paraqet analizën konkrete që e mbështet këtë rezultat:** nuk identifikon kontratat dhe vlerat që plotësojnë minimumin prej 40.000,00 €, nuk shpjegon bindshëm refuzimin e efektit sqarues të konfirmimit të AQS CERT dhe nuk tregon pjesët e raportit të rivlerësimit ku janë adresuar konstatimet e mëparshme.

Për rrjedhojë, AK-ja pohon se ka kryer rivlerësim të ligjshëm, por nuk demonstroi se si ka arritur në këtë përfundim. **Zbatimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0400 kërkon që çështjet që kanë sjellë kthimin në rivlerësim të trajtohen konkretisht dhe përfundimi për secilën të mbështetet në prova e arsyetim.**

Këtë mungesë transparence e përforcon edhe trajtimi i kërkesave tona për qasje. Më **31.08.2026** kemi kërkuar dokumentacionin e rivlerësimit dhe, përmes parashtresës **“Qartësim dhe plotësim i kërkesës për qasje në dokumentet e rivlerësimit”**, kemi sqaruar se kërkesa përfshin dokumentet e krijuara, pranuar dhe administruara gjatë këtij procesi.

Në përgjigjen e datës **01.09.2026**, AK-ja është mbështetur te mungesa e dokumenteve të reja nga operatorët ekonomikë. **Mungesa e dokumenteve të reja nga OE-të nuk e arsyeton refuzimin e qasjes në dokumentet e hartuara nga vetë AK-ja gjatë rivlerësimit**, përfshirë raportin e komisionit, analizën e ofertave dhe rekomandimin përfundimtar. Pikërisht këto dokumente do të tregonin nëse dhe si janë trajtuar mangësitë e evidentuara.

AK-ja nuk mund ta mbështesë refuzimin e pretendimit tonë në mungesën e provave për mënyrën e rivlerësimit, ndërkohë që nuk na vë në dispozicion dokumentacionin që e pasqyron atë. Kërkojmë administrimin e raportit të rivlerësimit që mbahet në dosje sipas **nenit 39.10 të Rregullores për Prokurimin Publik**, si dhe trajtimin e qasjes pas publikimit të B58 sipas **nenit 10 të LPP-së dhe nenit 7.6.3 të Rregullores**, duke mbrojtur vetëm pjesët për të cilat ekziston bazë ligjore për konfidencialitet.

Për këto arsye, kërkojmë që OSHP-ja ta aprovojë Pretendimin nr. 5 si të bazuar, të administrojë dosjen e plotë të rivlerësimit dhe të kontrollojë nëse AK-ja i ka adresuar në mënyrë përmbytëse çështjet e trajtuara në Vendimin nr. 2026/0400. Kërkojmë anulimin e rezultatit të rivlerësimit dhe të pjesës përkatëse të vendimit refuzues nëse konstatohet se rekomandimi është mbajtur në fuqi pa korrigjuar mangësitë dhe pa analizën e nevojshme. **Anulimi formal i B58 më 23.07.2026 nuk mjafton**

për ta konsideruar të zbatuar vendimin e OSHP-së, nëse vlerësimi pasues vazhdon të mbështetet në mangësitë që duhej të adresoheshin

## ***Pretendimi Nr.6***

### ***Rrethana faktike që kërkojnë verifikim për konflikt të mundshëm interesi***

OE i jonë pretendon se ekzistojnë rrethana që krijojnë indicie për konflikt interesi dhe që kërkojnë verifikim lidhur me raportin ndërmjet **KORABI Company SH.P.K.** dhe Operatorit Ekonomik të rekomanduar **S.V. "VETERINA" Safet Osmani B.I.**

Nga dokumentacioni i siguruar gjatë qasjes në dokumente të datës 08.06.2026, si dhe nga verifikimet dhe **hulumtimet shitesë** që kemi ndërmarrë si OE, është identifikuar një element që kërkon vëmendje të veçantë!! Ndërkohë, dokumentacioni tregon një marrëdhënie të përsëritur tregtare ndërmjet **KORABI Company** dhe **S.V. "VETERINA"**, përmes:

- *Fatura nr. 8/20, (pa datë) lëshuar nga KORABI Company SH.P.K.;*
- *Fatura nr. 9/20, (pa datë) e lëshuar nga KORABI Company SH.P.K.;*
- *Fatura nr. 31/2020, e datës 15.10.2020, e lëshuar nga KORABI Company SH.P.K.;*
- *Fatura nr. 32/2020, e datës 15.10.2020, e lëshuar nga KORABI Company SH.P.K.;*
- *Fatura nr. 33/2020, e datës 15.10.2020, e lëshuar nga KORABI Company SH.P.K.*

Veçanërisht relevante është **Fatura nr. 32/2020**, në të cilën **KORABI Company** i ka faturuar **S.V. "VETERINA"** pajisje me emërtimet **"Pomp elektrike ULV 220V"** dhe **"Fungator për Ambient Bren/UL"**, ndërsa në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit paraqiten kërkesa pothuajse identike: **"Pomp elektrike ULV 220 V"** dhe **"Fungator për ambiente të brendshme"**.

Kur merret parasysh së bashku **pronësia e KORABI Company**, numri i faturave të lëshuara për **S.V. "VETERINA"** dhe përputhja e terminologjisë së pajisjeve me Dosjen e Tenderit, konsiderojmë se ekziston një lidhje faktike e mjaftueshme që të verifikohet nëse këto rrethana kanë **krijuar konflikt real, potencial apo të perceptueshëm interesi**, si dhe nëse informacionet ose dokumentacioni i **KORABI Company** kanë pasur ndonjë ndikim në formulimin e specifikimeve teknike.

Ne nuk e paraqesim këtë si konstatim përfundimtar, por si **pretendim të mbështetur në dokumente konkrete te cilat ne i kemi ne dispozicion!!!**.

Andaj, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të verifikohet në mënyrë të dokumentuar lidhja ndërmjet ktyre dy kompanive si dhe çdo rrethanë që mund të përbëjë konflikt interesi apo ndikim në përgatitjen e specifikimeve teknike.

### **Pergjigja e Autoritetit Kontraktues per pretendimin Nr.6:**

Parashtruesi pretendon se ekzistojnë rrethana që, sipas tij, krijojnë indicie për konflikt të mundshëm interesi ndërmjet **KORABI Company SH.P.K.** dhe Operatorit Ekonomik të rekomanduar **S.V. "VETERINA" Safet Osmani B.I.**

Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i referohet faturave dhe dokumenteve të tjera që, sipas tij, dëshmojnë marrëdhënie tregtare ndërmjet këtyre subjekteve, si dhe ngjashmëri ndërmjet disa pajisjeve të faturuara dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se dokumentet dhe indiciet e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të konstatuar ekzistencën e një konflikti real, potencial apo të perceptueshëm interesi në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit.

Marrëdhëniet tregtare ndërmjet subjekteve ekonomike, në mungesë të provave konkrete për ndikim në procesin e prokurimit ose për ekzistencën e një rrethane të përcaktuar me ligj si konflikt interesi, nuk mund të konsiderohen në vetvete dëshmi për konflikt interesi.

Autoriteti Kontraktues ka kompetencë të shqyrtojë ligjshmërinë e procesit të prokurimit, ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit të dorëzuar nga Operatorët Ekonomikë.

Në rast se parashtruesi disponon prova konkrete, të besueshme dhe të verifikueshme që dëshmojnë ekzistencën e një konflikti interesi ose ndonjë shkeljeje tjetër, ai gëzon të drejtën që këto prova t'i paraqesë pranë organit kompetent në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Megjithatë, në bazë të provave të paraqitura në kuadër të kësaj Kërkese për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore dhe faktike për të konstatuar konflikt interesi.

## Kundershtimi yne:

AK-ja, në vendimin refuzues, shprehet:

*“Parashtruesi pretendon se ekzistojnë rrethana që, sipas tij, krijojnë indicie për konflikt të mundshëm interesi ndërmjet KORABI Company SH.P.K. dhe Operatorit Ekonomik të rekomanduar S.V. ‘VETERINA’ Safet Osmani B.I.”*

**Pretendimi ynë mbështetet në dokumente konkrete të paraqitura nga vetë OE-ja e rekomanduar.** Qysh në **Kërkesën për Rishqyrtim**, kemi ngritur shqetësimin se **Fatura nr. 32/2020 e KORABI Company SH.P.K.**, e përfshirë në dokumentacionin e S.V. “VETERINA”, përmban emërtime pajisjesh pothuajse identike me ato të përcaktuara nga AK-ja në **Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit**. Pra, kjo rrethanë dokumentare ishte evidentuar dhe i ishte paraqitur AK-së që në fazën e parë të kundërshtimit të vlerësimit.

Subjekti që figuron si lëshues i faturave është **KORABI Company SH.P.K., me numër unik identifikues 810690182**. Përputhja e të dhënave identifikuese në faturat e dorëzuara nga S.V. “VETERINA” e lidh dokumentacionin tregtar me të njëjtin subjekt juridik. Konkretisht, bëhet fjalë për:

- **Faturën nr. 8/20**, pa datë të shënuar;
- **Faturën nr. 9/20**, pa datë të shënuar;
- **Faturën nr. 31/2020**, të datës **15.10.2020**;
- **Faturën nr. 32/2020**, të datës **15.10.2020**;
- **Faturën nr. 33/2020**, të datës **15.10.2020**.

**Këto fatura përbëjnë bazën dokumentare të pretendimit tonë për marrëdhënien tregtare ndërmjet Korabi Company SH.P.K. dhe S.V Veterina.** Të shqyrtuara së bashku me të dhënat për pronësinë e Korabit dhe rolin e zyrtarit të prokurimit, ato kërkojnë verifikim konkret të rrethanave të konfliktit të mundshëm të interesit. Ngjashmëria e emërtimeve të pajisjeve kërkon gjithashtu shqyrtim të mënyrës së hartimit të specifikimeve, pa u paraqitur vetvetiu si provë përfundimtare e ndikimit në to.


#### PROVA NR. 1 – Të dhënat identifikuese të KORABI Company SH.P.K. sipas ARBK-së

|                         |                                    |
|-------------------------|------------------------------------|
| Emri i biznesit         | Korabi -Company SH.P.K.            |
| Emri tregtar            |                                    |
| Lloji biznesit          | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar |
| Numri unik identifikues | 810690182                          |
| Numri i biznesit        | 70147017                           |
| Numri Fiskal            | 600007076                          |
| Numri punëtorëve        | 14                                 |
| Data e regjistrimit     | 06/05/2004                         |
| Komuna                  | Vushtrri                           |
| Adresa                  | p.n., e Tiranës                    |

#### PROVA NR. 2 – Ilmi Azemi i paraqitur si pronar/aksionar me 100% të kapitalit

Në pamjet e ARBK-së, z. Ilmi Azemi

##### Pronar/ Aksionarë



**Fakti bazë: z. Ilmi Azemi figuron në provat e ARBK-së si pronar i KORABI Company dhe njëkohësisht është Drejtor i Prokurimit në Komunën e Vushtrrisë, me akte të kësaj procedure të nënshkruara prej tij.**

**Marrëdhënia tregtare KORABI Company dhe S.V. "VETERINA" është e përsëritur dhe e dokumentuar**

Dokumentacioni i siguruar përmes qasjes në dokumentet e OE të rekomanduar nuk përmban vetëm një faturë të vetme. Ai përmban së paku pesë fatura të KORABI Company të lëshuara për S.V. "VETERINA". Kjo tregon një marrëdhënie tregtare të përsëritur ndërmjet kompanisë së identifikuar më lart dhe OE-së së rekomanduar për kontratë.

Veçanërisht e rëndësishme është se Fatura nr. 8/20 dhe Fatura nr. 9/20 përmbajnë shprehimisht emrin "ILMI AZEMI" në pjesën e shitësit/faturuesit, pranë vulës së KORABI Company. Në këto dokument figuron emri Ilmi Azemi në faturat e shitjes të lëshuara nga Korabi Company për S.V. Veterina.

**PROVA NR. 3 – Fatura 8/20:**



**PROVA NR. 4 – Fatura 9/20:**



## Fatura nr. 32/2020 dhe përputhja me Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit

Fatura nr. 32/2020, datë 15.10.2020, është dokumenti kryesor për çështjen e përshtatjes së mundshme të specifikimeve. Në të figurojnë, ndër të tjera, “Pomp elektrike ULV 220V” dhe “Fungator për Ambient Bren/UL”; ndërsa në Aneksin 8 të DT-së janë kërkuar “Pomp elektrike ULV 220 V” dhe “Fungator për ambiente të brendshme”.

### PROVA NR. 5 – Fatura nr. 32/2020: emërtimet e pajisjeve që përkojnë me kërkesat e DT-

| Bleresi   |                                | Nr. 32/2020     |               |    |               |               |               |
|-----------|--------------------------------|-----------------|---------------|----|---------------|---------------|---------------|
| Emri      | S.V. VETERINA Safet Osmani B.I | Data:15.10.2020 |               |    |               |               |               |
| Adesa     | Vushtrri                       |                 |               |    |               |               |               |
| NR Fiskal | 810692857                      |                 |               |    |               |               |               |
| Nr.       | Pershkrimi                     | Sasia           | Cmimi pa TVSH | %  | Cmimi me TVSH | Vlera pa TVSH | Total me TVSH |
| 1         | Autonizer mjegullues për DD    | 4               | 15.25         | 18 | 18.00         | 61.02 €       | 72.00 €       |
| 2         | Pomp elektrike ULV 220V        | 3               | 29.66         | 18 | 35.00         | 88.89 €       | 105.00 €      |
| 3         | Nobelizator ULV I vogel        | 2               | 32.20         | 18 | 38.00         | 64.41 €       | 76.00 €       |
| 4         | Fungator për Ambient BrenUVL   | 2               | 27.11         | 18 | 32.00         | 54.22 €       | 64.00 €       |
| 5         |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 6         |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 7         |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 8         |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 9         |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 10        |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 11        |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 12        |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 13        |                                |                 |               |    |               |               |               |
| 14        |                                |                 |               |    |               |               |               |

Në qershor kjo përputhje ishte evidentuar si një rrethanë që mund të meritonte vëmendje. Tashmë, duke pasur parasysh edhe të dhënat nga ARBK-ja dhe faturat në raportin ndërmjet KORABI Company dhe S.V. “VETERINA”, konsiderojmë se do të ishte e arsyeshme të ofrohet një sqarim i dokumentuar lidhur me origjinën e specifikimeve teknike.

### Faturat nr. 31/2020 dhe nr. 33/2020 e forcojnë modelin e pajisjeve ULV

Faturat nr. 31/2020 dhe nr. 33/2020, të dyja të datës 15.10.2020, janë lëshuar po ashtu nga KORABI Company për S.V. VETERINA Safet Osmani B.I. dhe përmbajnë pajisje të kategorisë ULV: “Pomp elektrike Benz. ULV” dhe “Pomp elektrike ULV (me Bateri) për Ambient të Brendshëm”.

Nënshkrimet e verejtura ne faturat e Korabi Company SH.P.K. jane te njejta me nenshkrimet e publikuara nga AK ne komunikimet e kti AP.



*Ilmi Azemi*  
*[Signature]*  
*Drejtore i Drejtorisë*

*Ilmi Azemi*  
*Drejtore i Prokurimit*  
*Komuna e Vushtrrisë*  
*[Signature]*

#### Dyshim per konflikt te interesit

Në këto rrethana, konsiderojmë se gjatë vlerësimit mund të merret parasysh edhe dokumentacioni në dispozicion. Nga ky dokumentacion rezulton se z. Ilmi Azemi figuron si pronar i KORABI Company, kompani e cila ka lëshuar fatura për S.V. “VETERINA”. Në disa prej këtyre faturave figuron edhe emri “ILMI AZEMI”, ndërsa Fatura nr. 32/2020 përmban emërtime që përkojnë me disa prej emërtimeve të Aneksit 8. Po ashtu, z. Ilmi Azemi ka nënshkruar akte të këtij aktiviteti në cilësinë e Drejtorit/Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit. Vlerësojmë se këto rrethana mund të shqyrtohen së bashku për një sqarim sa më të plotë të çështjes.

Në këto rrethana, konsiderojmë se është e rëndësishme që të sqarohet në mënyrë të dokumentuar nëse gjatë hartimit të specifikimeve teknike, vlerësimit dhe vendimmarrjes janë ndërmarrë masat e nevojshme për garantimin e paanshmërisë së procedurës.

**Neni 7 i LPP-së** kërkon trajtim të barabartë, jodiskriminues dhe transparent të operatorëve ekonomikë, ndërsa **neni 28 i LPP-së** përcakton kërkesat lidhur me hartimin e specifikimeve teknike në mënyrë që të mos krijohen pengesa të pajustificuara për konkurrencën. Po ashtu, **neni 39.13 i Rregullores për Prokurimin Publik**, lidhur me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit, parasheh deklarinimin dhe trajtimin e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit.

Për këtë arsye, kërkojmë që rrethanat dhe dokumentet e paraqitura të shqyrtohen në mënyrë të plotë dhe të paanshme dhe, sipas nevojës, të jepen sqarimet përkatëse lidhur me mënyrën se si janë zbatuar këto kërkesa gjatë zhvillimit të procedurës.

Në varësi të vlerësimit dhe sqarimeve që do të ofrohen, GOE-ja jonë rezervon të drejtën që dokumentacionin përkatës t'ua paraqesë edhe institucioneve kompetente, sipas fushëveprimit të tyre, për çdo verifikim që mund të konsiderohet i nevojshëm.

Kërkojmë që dokumentet lidhur me marrëdhëniet e paraqitura ndërmjet subjekteve, përshkrimin e pajisjeve dhe rolin e personave të përfshirë në procedurë të vlerësohen në tërësi, në mënyrë që të sqarohet nëse këto rrethana kanë pasur ndonjë ndikim në zhvillimin e procedurës.

**Kërkojmë që Pretendimi nr. 6 të shqyrtohet dhe të aprovohet si i bazuar, si dhe të bëhet një verifikim i plotë dhe i dokumentuar lidhur me origjinën e specifikimeve teknike, marrëdhënien ndërmjet KORABI Company dhe S.V. "VETERINA", si dhe rolin e z. Ilmi Azemi në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, vlerësojmë se çdo rrethanë që mund të ngrejë çështje lidhur me paanshmërinë duhet të trajtohet në përputhje me dispozitat përkatëse.**

Duke qenë se këto rrethana tashmë janë paraqitur së bashku me dokumentacionin përkatës, konsiderojmë se ato meritojnë të shqyrtohen dhe të sqarohen në kuadër të kësaj procedure.

Veprimet dhe mosveprimet e AK-së të trajtuara në këtë ankesë, sipas vlerësimit tonë, ngrenë çështje që lidhen me respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe vlerësimit objektiv. Po ashtu, konsiderojmë se çështjet e ngritura gjatë procesit të rivlerësimit nuk janë sqaruar në mënyrë të mjaftueshme, ndërkohë që rezultati ka qenë eliminimi i GOE-së sonë dhe rekomandimi i përsëritur i OE-së S.V. "VETERINA". Për këtë arsye, kërkojmë që këto çështje të vlerësohen dhe të arsyetohen në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme.

**Andaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:**

- **Ta aprovojë ankesën në tërësi si të bazuar dhe t'i aprovojë pretendimet nr. 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6;**
- Ta anulojë **Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 31.08.2026**, përfshirë eliminimin e kundërshtuar të GOE-së sonë dhe rekomandimin e S.V. "Veterina" për kontratë;
- Të konstatojë mosplotësimin nga OE-ja e rekomanduar të kriterit minimal të përvojës së ngjashme, sipas provave të paraqitura, dhe ta obligojë AK-në që ofertën që nuk përmbush këtë kriter ta trajtojë si të papërgjegjshme;

- Ta kthejë aktivitetin në **rivlerësim të plotë, objektiv dhe të ligjshëm**, duke e obliguar AK-në të zbatojë në mënyrë përmbajtësore **Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0400, datë 22.07.2026**, si dhe konstatimet që dalin nga shqyrtimi i kësaj ankese;
- Ta obligojë AK-në ta rivlerësojë ofertën e GOE-së sonë sipas kërkesave të publikuara dhe provave përkatëse, **pa kritere të papublikuara dhe pa standarde të dyfishta**;

Gjithashtu, kërkojmë që **OSHP-ja, brenda kompetencave të saj, ta ndjekë zbatimin e vendimit**, duke marrë parasysh mënyrën se si është zhvilluar kjo procedurë deri më tani, favorizimet e evidentuara, trajtimin e pabarabartë, përgjigjet e përgjithshme të AK-së dhe mosshqyrtimin përmbajtësor të pretendimeve tona, **kërkojmë nga OSHP** që kjo procedurë të mbikëqyret me kujdes deri në përfundimin e saj, përfshirë fazën e rivlerësimit, rekomandimit për kontratë dhe deri në nënshkrimin eventual të kontratës.

Kjo kërkesë bëhet me qëllim që të parandalohet vazhdimi i vlerësimit të njëanshëm, favorizues dhe diskriminues, si dhe që kjo procedurë e prokurimit të zhvillohet në përputhje të plotë me parimet e ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së ndershme dhe mbrojtjes së interesit publik.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Eliminimin e pabazuar të ofertës sonë nga procedura;**

**Humbjen e mundësisë reale për fitimin dhe realizimin e kontratës;**

**Humbjen e të ardhurave dhe fitimit të mundshëm nga realizimi i kontratës;**

**Trajtimin e pabarabartë dhe cenimin e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë;**

**Shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë rreth 500.00 €;**

**Shpenzime për përgatitjen e Ankesës në OSHP që kapin vlerën prej 1000.00 €;**

**Shpenzimet shtesë për sigurimin dhe vazhdimin e validitetit të tenderit;**

**Shpenzimet administrative dhe profesionale për përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, sigurimin e provave, verifikimet dhe komunikimet shtesë;**

**Angazhimin shtesë të stafit dhe resurseve të OE-së për ndjekjen e një procedure të zgjatur për shkak të rivlerësimeve dhe veprimeve të kontestuara;**

**Shpenzimet për angazhimin e ekspertëve dhe profesionistëve të fushës juridike dhe të prokurimit publik për analizimin e procedurës, përgatitjen e mjeteve juridike dhe trajtimin e çështjeve të ngritura, në vlerë rreth 3,000.00 €**

Shpenzimet për blerjen dhe sigurimin e materialeve, preparateve dhe mjeteve të nevojshme për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, të ndërmarra pas Vendimit të OSHP-së dhe në pritje të vazhdimit të rregullt të procedurës në vlerë rreth 5,000.00 €;

Bllokimin dhe angazhimin e kapaciteteve financiare, teknike dhe profesionale të OE-së gjatë vazhdimit të procedurës;

Rrezikun e humbjes së mundësive të tjera afariste për shkak të angazhimit të resurseve në këtë aktivitet të prokurimit.

Shpenzime për përgatidjen e Ankesës së dytë në OSHP që kapin vlerën prej 1000.00 €;

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*